

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6820
E mërkurë, 8 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Gjukanoviqi: E mbështetim rrugën evropiane të Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI E PRANON PROPOZIMIN E BE-së, OPOZITA KËRKON RAPORTIM NË KUVEND

FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se e pranon propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, "duke e konsideruar atë një bazë të

mirë për diskutime të mëtejshme dhe një platformë solide për të ecur përpara". Përfaqësuesit e opozitës kanë kërkuar që kryeministri Kurti të raportojë në Kuvend për procesin e dialogut me Serbinë.

Ndërkaq ambasadori i ShBA-së, Jeff Hovenier, e ka mirëpritur vendimin e Kosovës që ta pranojë në parim propozimin evropian për normalizimin e raporteve me Serbinë

TURQIA SHPALL GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME PËR TRE MUAJ

FAQE 3



PAGA E ASAMBLISTIT DO TË JETË NGA 556 EURO DERI NË 630 EURO

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**ABDIXHIKU: PO HYJMË NË VITIN
E TRETË TË QEVERISJES ME
PËRPLLOT PREMTIME TË PABËRA** F. 5

**SHKENCËTARI NGA DEÇANI SJELL
NJË VIZION TË RI SHKENCOR NË
FIZIKË** F. 6

**500 MIJË EURO DËMI I SHKAKTUAR
NGA VËRSHIMET NË OBJEKTET
SHKOLLORE NË SKENDERAJ** F. 6

EKONOMI



**ATK-ja: BIZNESET ONLINE
JANË TË OBLIGUARA TË LËSHOJNË
KUPON FISKAL** F. 8

**ZZRRE-ja PARALAJMËRON
SËRISH SHTRENTJIM
TË ENERGJISË ELEKTRIKE** F. 8

SPORT



**EKIPI I MUNDJES I KOSOVËS
ARRIN NË STAMBOLL** F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjukanoviqi: E mbështetim rrugën evropiane të Kosovës

PODGORICË, 7 SHKURT - "Ne i kuptojmë ambicet e Kosovës për t'u bërë anëtare e Këshillit të Evropës, për ta marrë statusin vendit kandidat në Bashkimin Evropian dhe e mbështetim fuqishëm këtë", ka thënë presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç të martën para gazetarëve në Podgoricë, pas takimit me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në vizitën e saj të parë zyrtare në këtë shtet.

Osmani ka thënë se Mali i Zi deri më tani ka treguar mbështetje të qartë për Kosovën në të gjitha fushat. "Mali i Zi dhe Kosova janë shtete sovraane dhe qartësisht të përkushtuara në rrugën e anëtarësimit në BE. Ne do të vazhdojmë të punojmë me synimin për t'i zgjidhur çështjet e së kaluarës sonë të dhimbshme. Ne do të vazhdojmë në rrugën e

paqes dhe stabilitetit", ka deklaruar Osmani.

Ajo e ka falënderuar Gjukanoviçin për mbështetjen e tij dhe ka thënë se anëtarësimi i Malit të Zi në NATO i kontribuoi paqes në të gjithë rajonin.

Duke folur për raportet e ndërsjella, të cilat, sipas tyre, janë të rëndësishme dhe miqësore, Gjukanoviç tha se ka punë përpara që pakica malazeze në Kosovë të përfshihet në Kushtetutën e Kosovës si komunitet zyrtar.

Gjukanoviç ka thënë se Mali i Zi po ndjek me kujdes gjithçka që po ndodh në negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

"Ne jemi të bindur se mund të arrihet një marrëveshje e qëndrueshme. Me zgjidhjen e kësaj çështjeje do të zgjidhej dukshëm çështja e stabilitetit e këtij rajoni", ka theksuar



Gjukanoviç.

Osmani tha se gjatë takimit është biseduar për potencialin e jashtëzakonshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve. Gjukanoviç dhe Osmani do të

marrin pjesë në panelin e presidentëve "Zhvillimi i ngjarjeve në Ballkanin Perëndimor: Sfidat për paqen dhe stabilitetin në dritën e krizës rajonale dhe globale", organizuar

nga Lëvizja Evropiane në Mal të Zi.

Në ditën e dytë të vizitës, presidentja Osmani do ta vizitojë komunën e Tuzit dhe të Ulqinit, ku jetojnë kryesisht shqiptarët në Mal të Zi.

Qeveria e Malit të Zi, e udhëhequr nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e presidentit Gjukanoviç, e njohu Kosovën në tetor të vitit 2008, tetë muaj pas vendimit të Prishtinës për ta shpallur pavarësinë.

Në të njëjtën kohë, opozita e atëhershme malazeze, e udhëhequr nga lideri i Frontit Demokratik, Andrija Mandiq, protestoi duke kërkuar anulimin e vendimit për njohjen e Kosovës. Pas tri dekadash në pushtet, DPS e Gjukanoviçit humbi zgjedhjet e gushtit 2020. Aktualisht ajo është partia më e fortë opozitare në Mal të Zi.

Rusia vazhdon sulmet në lindje të Ukrainës, rritet frika për një ofensivë të re

KIEV, 7 SHKURT - Forcat pushtuese ruse po vazhdojnë sulmet përgjatë vijës së frontit në lindje të Ukrainës, tha ushtria e Kievit më 7 shkurt, teksa zyrtarët ukrainas kanë vazhduar të paralajmërojnë se Moska po përgatitet për një ofensivë të re në këtë rajon.

Gjatë 24 orëve të fundit ushtria ruse ka kryer gjashtë sulme me raketa dhe 24 sulme ajrore, tha Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase. Shtabi, po ashtu, tha se ka pasur 75 sulme me artileri, përfshirë një ndaj një objekti civil në rajonet lindore dhe juglindore të Harkivit, Donjeckut, Dnipropetrovskit dhe Hersonit. Ushtria shtoi se ka pasur një numër të paspecifikuar të viktimave në mesin e civilëve.

Më vonë, Pavlo Kyrilenko, kreu i administratës ushtarake në Donjeck, raportoi se një person është vrarë dhe pesë të tjerë janë plagosur si rezultat i granatimeve gjatë natës në rajonin e Donjeckut. Gjatë 24 orëve të fundit 1 030



ushtarë rusë janë vrarë në Ukrainë, pretendoi ushtria ukrainase më 7 shkurt, edhe pse shifra të tilla është e pamundur të konfirmohen në mënyrë të pavarur.

Luftimet e reja vijnë pasi guvernatori i Luhanskut, Serhiy

Hayday, tha se Rusia po dislokoi përforcime në lindje të Ukrainës para një ofensive të re të mundshme. "Po shohim shumë e më shumë rezervistë rusë që po dislokohen në drejtim tonin, ne po shohim se po sillen më shumë

pajisje", tha Hayday për televizionin ukrainas më 6 shkurt. "Ata po sjellin municion që përdoret ndryshe nga më herët - tani nuk ka granatime të vazhdueshme. Ata ngadalë kanë filluar ta ruajnë municionin, të bëhen gati për një ofensivë të

shkallës së gjerë", tha Hayday.

Inteligjenca britanike, në përditësimin ditor për luftën në Ukrainë, tha se ushtria ruse ka të ngjarë që nga fillimi i janarit po përgatitet që të kryejë në ofensivë të madhe, me qëllim që ta marrë kontrollin e pjesëve të Donjeckut që kontrollohen nga Ukraina. Megjithatë, forcat ruse kanë bërë përfitime të pakta në terren, pasi "kanë mungesë municionesh dhe njësi manovruese, që duhen për një ofensivë të suksesshme", tha Ministria e Mbrojtjes e Britanisë.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se forcat ukrainase po luftojnë përpjekjet e trupave ruse që kanë rrethuar qytetin e Bahmutit dhe po tentojnë ta thyejnë mbrojtjen e qytetit.

Për muaj të tërë Rusia ka përqendruar përpjekjet e saj për të marrë Bahmutin, që gjendet në lindje të Ukrainës. Sipas medieve, në këtë zonë janë përfshirë edhe mercenarët e grupit rus Wagner (Wagner).

OKB-ja: Pothuajse 8 milionë persona janë larguar nga Ukraina

NYU-JORK, 7 SHKURT - Koordinator i Ndihmë Emergjente i Kombeve të Bashkuara, Martin Griffiths, tha se pothuajse 8 milionë persona janë larguar nga Ukraina që kur nisi konflikti gati një vit më parë.

Pothuajse 8 milionë persona janë larguar nga Ukraina për në shtetet fqinje, ndërkaq 5.3 milionë persona të tjerë janë zhvendosur brenda vendit, tha Griffiths në mbledhjen e Këshillit

të Sigurimit të OKB-së.

Kreu i Zyrës për Koordinim dhe Çështje Humanitare të OKB-së tha se 17.6 milionë persona, apo pothuajse 40 për qind e popullatës së Ukrainës, ka nevojë për ndihmë humanitare.

Griffiths tha se më vonë gjatë këtij muaji në Gjenevë do të prezantojë Planin për Përgjigje Humanitare për Ukrainën. Ai tha se ky plan kërkon një shumë prej 3.9-miliardë dollarësh. "Dhuna

nuk po tregon asnjë shenjë që po zbutet", tha ai.

Mbi 7 000 civilë janë vrarë që kur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022, thuhet në shifrat e prezantuar nga OKB-ja. "Numri real i viktimave sigurisht që është më i lartë", tha Griffiths. Sipas Agjencisë së OKB-së për Refugjatë, lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka shkaktuar lëvizjen më të madhe të refugjatëve që nga Lufta e Dytë Botërore.



Turqia shpall gjendje të jashtëzakonshme për tre muaj

Tërmeti që goditi Turqinë dhe Sirinë në orët e para të mëngjesit të së hënës ka lënë të vdekur mbi 5 000 persona në këto dy shtete dhe ka lënduar mijëra të tjerë. Për shkak të tërmetit të fuqishëm, që u pasua me dridhje të tjera të fuqishme të tokës, shumë persona kanë mbetur pa strehë në temperatura të ulëta. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme për tre muaj



Ankara, 7 shkurt - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme për tre muaj. Gjendja e jashtëzakonshme do të jetë në dhjetë qytetet e prekura nga tërmetet: Gaziantep, Kahramanmaraş, Hatai, Osmanije, Adijamana, Malatia, Shanlëurfa, Adana, Dijarbakër dhe Kilis.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme vjen në kohën kur në Turqi dhe Siri po vazhdojnë përpjekjet për t'i shpëtuar personat që besohet se kanë mbetur nën rrënojat e mijëra ndërtesave të shkatërruara nga tërmetet e fuqishme që goditën këto dy shtete.

Mbi 5 000 persona raportohet se kanë vdekur, pasi një tërmet prej 7.8-ballësh goditi në orët e para të mëngjesit të 6 shkurtit. Epiqendra e tërmetit të së hënës ishte rreth 26 kilometra nga qyteti Nurdagi dhe rreth 33 kilometra larg qytetit Gaziantep, tha Shërbimi Gjeologjik amerikan. Po ashtu, gjatë po asaj dite u regjistrua një tërmet tjetër i fuqishëm prej 7.5-shkallësh të rihterit.

Ekipe me specialistë nga vende anembanë botës janë mobilizuar për të ofruar ndihmë në operacionet e kërkim-shpëtimit në Turqi e Siri.

Një ekip i ndihmës nga Shqipëria është nisur drejt Turqisë më 6

shkurt. Ekipi përbëhet nga 53 persona - personel mjekësor dhe specialistë të kërkim-shpëtimit. Po ashtu, edhe një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës është nisur drejt Turqisë më 6 shkurt. Kontingjenti përbëhet nga specialistë të kërkim-shpëtimit urban, personel mjekësor ushtarak dhe qen shpëtimi.

Agjencia për Fëmijë e Kombeve të Bashkuara (UNICEF) tha se tërmetet dhe goditjet pasuese, që shkatërruan mijëra ndërtesa në Turqi dhe Siri, mund të kenë vrarë mijëra fëmijë. "Tërmetet që goditën jugun e Turqisë dhe veriun e Sirisë mëngjesin e ditës së djeshme, mund të kenë vrarë mijëra fëmijë", tha zëdhënësi i UNICEF-it, James Elder. Ai shtoi se kjo agjenci e OKB-së nuk ka mundur ta saktësojë numrin e fëmijëve të vrarë.

Pse ishte kaq i rëndë tërmeti në Turqi e Siri?

Tërmeti me magnitudë prej 7.8-ballësh që goditi Turqinë dhe Sirinë mëngjesin e së hënës ka të ngjarë të jetë një nga më vdekjeprurësit këtë dekadë, thanë sizmologët, me një thyerje prej më shumë se 100 kilometrash (62 milje) midis blloqeve të Anadollit dhe Arabisë. Këtu është ajo që shkencëtarët thanë se ndodhi

nën sipërfaqen e tokës dhe ajo se çfarë duhet të prisni pas kësaj. Epiqendra e tërmetit ishte rreth 26 kilometra në lindje të qytetit turk Nurdagi, në një thellësi prej rreth 18 kilometrash në rajonin e Anadollit Lindor. Tërmeti u përhap drejt verilindjes, duke shkakuar shkatërrime në Turqi dhe Siri.

Gjatë shekullit XX rajoni i Anadollit Lindor tregoi aktivitet pak më të madh sizmik. "Nëse do të shkonim, thjesht, nga tërmetet (e mëdha) që u regjistruan nga sizmometrat, do të dukej pak a shumë bosh", tha

Roger Musson, një bashkëpunëtor nderi i kërkimit në Shërbimin Gjeologjik Britanik.

Që nga viti 1970 në këtë zonë janë regjistruar vetëm tri tërmete me magnitudë mbi 6.0 ballësh të shkallës së Rihterit, sipas Shërbimit Gjeologjik të ShBA-së. Por, më 1822, një tërmet prej 7-ballësh goditi rajonin, duke lënë të vdekur rreth 20 000 njerëz.

Mesatarisht, më pak se 20 tërmete mbi 7-ballësh ndodhin në çdo vit, duke e bërë ngjarjen e së hënës të rëndë.

Krahasuar me tërmetin prej 6.2-ballësh që goditi Italinë qendrore në vitin 2016 dhe vrau rreth 300 njerëz, tërmeti Turqi - Siri lëshoi 250 herë më shumë energji, sipas Joanna Faure Walker, drejtuese e Institutit të Kolegjit Universitar të Londrës për Reduktimin e Rrezikut dhe Fatkeqësive.

Vetëm dy nga tërmetet më vdekjeprurëse nga viti 2013 deri në vitin 2022 ishin të së njëjtës magnitudë me tërmetin e së hënës.

Rajoni i Anadollit Lindor është një zonë ku ndodhin lëvizje të shtresave shkëmbore. Në to pllakat e ngurta shkëmbore shtyhen kundër njëra-tjetrës përgjatë një linje prishjeje vertikale, duke krijuar presion derisa njëra më në fund rrëshqet në një lëvizje horizontale, duke u liru nga tendosja e madhe që mund të shkaktojë një tërmet.

Rajoni i San Andreas në Kaliforni është ndoshta zona më e famshme e lëvizjes së pllakave shkëmbore në botë, ku shkencëtarët paralajmëruan të ndodhte një tërmet kohë më parë. Thyerja fillestare për tërmetin Turqi - Siri filloi në një thellësi relativisht të cekët. "Lëkundja në sipërfaqen e tokës do të ketë qenë më e rëndë sesa për një tërmet më të thellë të së njëjtës magnitudë në burim", tha David Rothery, një gjeoshkencëtar planetar në Universitetin e Hapur në Britani.

Katër të arrestuar për shkak të postimeve "provokuese" për tërmetet

Policia turke tha të martën se ka arrestuar katër persona lidhur me postimet "provokuese" në rrjetet sociale pas tërmetit të fuqishëm prej 7.8-ballësh që goditi juglindjen e Turqisë.

Katër persona u arrestuan pasi zyrtarët policorë zbuluan llogari në rrjetet sociale që kishin shpërndarë "postime provokuese që kishin qëllim të nxinin frikë dhe panik", tha policia. Zyrtarët e rendit në Turqi shtuan se kanë nisur një hetim të gjerë lidhur me llogaritë në rrjetet

sociale, por nuk treguan se çfarë përmbajtje kanë këto postime. Rrjetet sociale në Turqi janë mbushur me postime të njerëzve që ankohen se ka mungesë të përpjekjeve për kërkim-shpëtimit në zonat e tyre, veçanërisht në Hataj.

Policia duket se ka adresuar këto pretendime të martën. "Adresa dhe informacionet e lokacionit për qytetarët që kërkojnë ndihmë konstatohen menjëherë dhe bëhet koordinimi", tha policia turke.



Kurti e pranon propozimin e BE-së, opozita kërkon raportim në Kuvend

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se e pranon propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, “duke e konsideruar atë një bazë të mirë për diskutime të mëtejshme dhe një platformë solide për të ecur përpara”. Përfaqësuesit e opozitës kanë kërkuar që kryeministri Kurti të raportojë në Kuvend për procesin e dialogut me Serbinë. Ndërkaq ambasadori i ShBA-së, Jeff Hovenier, ka mirëpritur vendimin e Kosovës që të pranojë në parim propozimin evropian për normalizimin e raporteve me Serbinë

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Shtetet e Bashkuara kanë mirëpritur vendimin e Kosovës që ta pranojë në parim propozimin evropian për normalizimin e raporteve me Serbinë. Sipas ambasadorit amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, “marrëveshja e përkohshme” do të sjellë përfitime për Prishtinën dhe Beogradin. “ShBA-ja është e inkurajuar dhe mirëpret vendimin e Kosovës që ta pranojë në parim propozimin e BE-së dhe ne do të vazhdojmë ta

ofrojmë mbështetjen tonë të plotë për dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Marrëveshja e përkohshme do të sjellë përfitime të konsiderueshme si për Kosovën ashtu edhe Serbinë”, ka shkruar ai në “Twitter”. Më 6 shkurt, pas një takimi me të dërguarin e Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se pranon propozimin e bllokut evropian. “Ne e pranojmë propozimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

dhe e konsiderojmë atë një bazë të mirë për diskutime të mëtejshme dhe një platformë solide për të ecur përpara”, ka thënë Kurti.

Lajçak tha pas takimit me Kurtin se kanë diskutuar ‘gjihtëçka’ që lidhet me dialogun, por se diskutimi ka qenë i përqendruar te propozimi evropian. Ai përsëriti qëndrimin se të gjitha marrëveshjet e nënshkruara në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të zbatohen.

Në takimin me emisarin evropian Kurti ishte i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Besnik Bislimi. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se plani franko-gjerman është i pranueshëm për Kosovën, pasi në të nuk ka Asociacion të Komunave me Shumicë Serbe. Por, ai e pranon se në atë plan Kosova e merr një obligim për zbatimin e marrëveshjeve të deritanishme. Dhe meqë këtë asociacion e ka hedhur poshtë Gjykata Kushtetuese, sipas tij, duhet të gjendet një formë e re e asociacionit.

Konjufca ka thënë se përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë kërkuar që të ruhet

konfidencialiteti dhe plani i njohur fillimisht si franko-gjerman, të mos bëhet publik. Ai ka zbuluar se kryeministri Albin Kurti e ka pasur këtë plan që nga shtatori 2022. “Këtë plan qeverisë, mesa e di unë, përfaqësuesit gjermanë dhe francezë ia kanë dorëzuar në shtator të vitit të kaluar, mirëpo ky plan është kërkuar nga vetë propozuesit që mos të ndahet shumë me publikun, të kufizohet maksimalisht për shkak që përderisa palët janë në biseda e sipër dhe u prezantohet fillimisht atyre, sepse procesi mund të shkatërrohet nëse nuk ruhet konfidencialiteti”, ka thënë Konjufca.

Sipas tij, kryeministri Kurti para tre muajsh ka thënë se ky plan është bazë e mirë që të vazhdohet më tutje. “Nuk e di përse i gjithë ky pluhur kur kryeministri ka thënë se ky plan është i pranueshëm për Kosovën për arsye se aty nuk përmendet kurrfarë Asociacioni”, është shprehur Konjufca.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se kryeministri Kurti e ka pranuar propozimin franko-gjerman, pa shpjeguar

asnjëherë për qytetarët e Republikës së Kosovës se çka përmban ai propozim. “Kështu, ai i dha drejtim një marrëveshjeje në fshehtësi, pa asnjë transparencë, duke lënë shumë pyetje pa përgjigje të cilat i brengosin qytetarët tanë. Ku mbetën kushtet e tij? Cilat prej tyre u plotësuan e cilat jo? A janë përfshirë në këtë plan edhe kushtet e Serbisë? A është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe a është pjesë e saj edhe themelimi i Asociacionit? Mbi të gjitha, a e përfshinë kjo marrëveshje njohjen e ndërsjellë?”, ka deklaruar Krasniqi.

Ai ka thënë se PDK-ja i ka bërë të qarta kohë më parë pesë shtyllat që i presin nga marrëveshja potenciale me Serbinë. “Gjihtëçka më pak është humbje e madhe për Kosovën, për të cilën përgjegjës i vetëm do të jetë Albin Kurti”, ka thënë Krasniqi.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sërish ka potencuar se Kosovës nuk i duhet një marrëveshje bazë që nuk përmban njohjen Kosovë - Serbi. Nga kjo parti përmes një njoftimit për medie kanë thënë se Kosovës

Abdixhiku: Po hyjmë në vitin e tretë të qeverisjes me përplot premtime të pabëra

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka publikuar një video ku ka kritikuar qeverinë aktuale në prag të përmbushjes së dyvjetorit qeverisës. Ai ka thënë se qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti po hyn

në vitin e tretë të qeverisjes “me përplot premtime të dhëna e të pabëra”. “Pas disa ditësh qeveria do të mbushë dy vjet në pushtet. Në një kohë kur familjet po përpiqen t’ia dalin mbanë, kur sistemi ynë shëndetësor është në krizë, kur të rinjtë tanë po largohen

nga vendi, kur kostoja e jetesës çdo ditë po rritet, e kur pagat e secilit mbesin të ulëta, qeveria do të festojë”, është shprehur Abdixhiku. Sipas tij, në këto dy vjet qytetarët kanë kuptuar se sa të pavlera u bënë premtimet e dhëna. “Kuptuam mungesën e

ndjeshmërisë së pushtetarëve në çdo krizë me të cilën përballen njerëzit tanë. Kuptuam arrogancën e brendshme e përplasjen e panevojshme me aleatë jashtë. Kuptuam pra paaftësinë qeverisëse për të dhënë ndryshimin që Kosova e meriton.

Gjatë ditëve në vijim do t’i numërojmë këto dështime sepse besojmë se Kosova mundet shumë më mirë. Do t’i ndajmë edhe planet tona sepse besojmë se vendi ynë meriton më mirë. Dhe Kosova do të bëhet më mirë”, ka theksuar i pari i LDK-së.



Haradinaj e bëri demarkacionin, Kurti po e bën asociacionin

PRISHTINË, 7 SHKURT - Analisti Albert Krasniqi ka shkruar në lidhje me demarkacionin e asociacionin. Ai në “Facebook” ka shkruar se Ramush Haradinaj dhe Albin Kurti i patën bashkuar kauzat sa ishin në opozitë për ta kundërshtuar qeverinë. “Njëri

me demarkacionin e tjetri me asociacionin. Si për ironi, Haradinaj kryeministër e bëri demarkacionin, e Kurti kryeministër po e bën asociacionin”, ka shkruar Krasniqi. Ai ka theksuar se njëjtë sikur Haradinaj që e paketonte marrëveshjen e

demarkacionit me një raport të komisionit për rishikim të marrëveshjes, Kurti po e bën me gjashtë kushtet e vendosura. “Në esencë, marrëveshjet mbesin të njëjta, vetëm shtohet hiri ndaj syve të publikut”, ka shkruar Krasniqi.

duhet një marrëveshje përfundimtare që në thelb ka njohjen e ndërsjellë ndërmjet dy vendeve si shtete të pavarura e sovranë. Po ashtu, LDK-ja kërkon raportim të kryeministrit Kurti në Kuvendin e Kosovës mbi procesin e dialogut. “Injorimi i institucionit të përfaqësuesve të popullit nuk i jep legjitimitet asnjë procesi jetik për vendin”, është theksuar në njoftimin e LDK-së.

Para disa ditësh lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se diskutimet dhe konsultat për Asociacionin kanë vetëm një synim: heqjen e pengesave të fundit drejt marrëveshjes së madhe me Serbinë për njohje të ndërsjellë. Ai ka thënë se Asociacioni është një obligim i

marrë që duhet të zbatohet në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe këtu çështja mbyllet. “Prandaj të gjithë ata që Asociacionin e paraqesin si çështje problematike, nuk e kanë hallin tek Asociacioni, por duan që Asociacionin ta përdorin si ‘mbulesë’ për ta kundërshtuar marrëveshjen e madhe. Këtë po e bën Serbia e, fatkeqësisht, këtë po e bën edhe kryeministri i Kosovës. Të gjitha vendimet dhe veprimet e qeverisë në Prishtinë e në Beograd, në këta 4-5 muajt e fundit, që nga çështja e targave, tensionet në veri, dalja nga institucionet e serbëve lokalë, e deri te shpallja e zgjedhjeve në veri, kanë qenë obstrukcionizëm i planit euro-amerikan”, ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar

se kjo lojë politike duhet të marrë fund dhe Kosova duhet t’i fokusojë krejt potencialet politike, intelektuale dhe qytetare në kryetëmën e saj që është “marrëveshja e madhe për njohje të ndërsjellë me Serbinë”, e cila mund të arrihet vetëm duke qenë të koordinuar ngushtë me ShBA-në dhe BE-në.

Propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi u është dorëzuar dy vendeve në fund të vitit të kaluar, por përmbajtja e tij nuk është bërë publike.

Ky propozim parasheh të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim të integritetit territorial, paprekshmëri të kufijve, njohje të simboleve shtetërore dhe një aranzhim të

veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Në dokument nuk përmendet njohja e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë apo anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara - për të cilat gjëra insistojnë publikisht zyrtarët kosovarë - por theksohet mbështetja që palët duhet t’i japin njëra-tjetres në procesin e integritimeve evropiane.

Propozimi i Bashkimit Evropian, që më herët njihej si plani franko-gjerman, ka marrë mbështetjen edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërkaq, më herët, gjatë së hënës, Kurti u takua me ambasadorët dhe diplomatët e akredituar të misionëve

diplomatike në Kosovë. Sipas njoftimit për medie të Zyrës së Kryeministrit, temë qendrore e diskutimit ishte procesi i dialogut, propozimi evropian dhe rruga përpara.

Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog nën ndërmjetësimin e BE-së që ka mbështetjen edhe të ShBA-së që nga viti 2011.

Procesi synon t’i normalizojë raportet mes shteteve, por Kosova dhe Serbia kanë pikëpamje të ndryshme sa i përket përfundimit të procesit.

Përderisa Prishtina kërkon që një marrëveshje finale ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Beogradi insiston në një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

Shkencëtari nga Deçani sjell një vizion të ri shkencor në fizikë


DEÇAN, 7 SHKURT - Shkencëtari nga Deçani, me punë dhe banim në Francë, ka botuar dje librin shkencor "Mikrobota, më ndryshe: një strukturë shumë më ndryshe e atomit". Sipas redaktorit të librit, Hajdin Abazi, me këtë libër Krasniqi ka sjellë një vizion të ri shkencor në fizikë.

"Të marrësh në duar një libër si ky është një rast tepër i rrallë, thuaja si përjashtim. Sepse ke një narracion krejt ndryshe

shkencor, që nuk haset askund tjetër. Vrushkujt e njëpasnjëshëm të ideve shfaqen sikur të ishte fjala për një magji. Janë ide krejt të reja, të padëgjua më parë nga asnjë shkencëtar. Të këto ide që, në fakt, janë fenomene në mikrobota e cila shpërfaqet me tjetër pamje metafizika, gjithsesi të panjohur. Kjo është forca që e bën pikëpamjen shkencore të Naim Krasniqit të jetë, thënë më së buti,

provokuese, sepse hap një perspektivë dhe horizont tërësisht të ri", ka shkruar Abazi për librin "Mikrobota, më ndryshe: një strukturë shumë më ndryshe e atomit".

Librin e ka botuar shtëpia botuese "Armagedoni" dhe nga e hëna mund ta gjeni nëpër libraritë e Prishtinës, kurse nga fundi i javës tjetër, edhe në libraritë e qyteteve të Kosovës dhe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.



Ministri Vitia takon kryetarin e Shtimes, planifikohen mbi 5 milionë euro investime

SHTIME, 7 SHKURT - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka vazhduar takimet dhe vizitat në komunat ku së shpejti do të fillojnë investimet në sektorin e shëndetësisë.

Ai të martën ka vizituar komunën e Shtimes, në të cilën është planifikuar ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, për të cilën Ministria e Shëndetësisë ka ndarë buxhet në vlerë prej 1 milion e 250 mijë eurosh si dhe ndërtimin e Entit Special në këtë komunë për të cilin janë ndarë 4 milionë euro.

Gjatë takimit me kryetarin e komunës së Shtimes, Qemajl Aliu dhe kabinetin e tij, ministri Vitia ka thënë se, përveç planifikimit për ndërtimin e projekteve kapitale, mbetet i përkushtuar për

përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Shtimes. "Ishte kënaqësi takimi me kryetarin Aliu. Me projektet e reja të cilat u prezantuan nga kryetari dhe drejtori i shëndetësisë, është tregues se në shëndetësi qytetarët e Shtimes në të ardhmen do të kenë shërbime shumë më cilësore. Sot biseduam edhe për dy projekte me rëndësi, siç janë ndërtimi i Entit Special dhe i QKMF-së në këtë komunë, projekte të cilat do të jenë në fokusin tonë dhe prioritete si Ministri e Shëndetësisë", ka thënë ministri Vitia.

Nga ana e tij, kryetari i komunës së Shtimes shprehi falënderimin për angazhimin e Ministrisë së Shëndetësisë që komuna e



Shtimes të ketë investime të rëndësishme në sektorin e shëndetësisë. Pas këtij takimi, së shpejti do të mbahet edhe një

takim i radhës me të gjitha ministrinë e linjës për ta definuar procesin dhe përgjegjësitë në kuadër të shtimit të kapaciteteve

dhe shërbimeve shëndetësore, si dhe ndërtimin e Entit Special dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në komunën e Shtimes.

Inaugurohen renovimet në shkollën "Rexhep Elmazi" në Gjilan

GJILAN, 7 SHKURT - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me nënkryetaren Leonora Morina Bunjaku dhe drejtorët komunalë, Albana Demiri (DKA) dhe Enver Shabani (DZHE), kanë inauguruar renovimet në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Rexhep Elmazi".

Kryetari Hyseni tha se këto investime që janë bërë tash nuk janë bërë në 20 vjetët e fundit, duke shtuar se përpos që sjellim ndryshim në kuptimin e infrastrukturës dhe asaj që duket vizualisht, do të sjellim ndryshime edhe përmbajtësisht në procesin e mësimor, por edhe në mësimnxënë. "Janë dy projekte që janë realizuar në të njëjtën kohë. Projekti i parë ka qenë me



Fondin Kosovar për Eficiencë të Energjisë, në kuadër të të cilit është bërë termo-izolimi në gjithë objektin, ndërrimi i dymave dhe

dritareve, izolimi i kulmit si dhe intervenimi në sistemin e ngrohjes, ndryshimin e metodës së ngrohjes nga dru në pelet.

Është bërë, po ashtu, lmyerja e gjithë objektit, pra një renovim i brendshëm në kuadër të komunës, përfshirë renovimin e

dysHEMEVE në disa klasa, nyjat sanitare, ndërrimin e tabelave që përdoren për shkrim, ndryshimi i sistemit të ndriçimit dhe disa çështje të tjera", ka thënë kryetari Hyseni.

Hyseni ka paralajmëruar se do të bëhen investime aty edhe te pjesa e laboratorëve në fushën e shkencave të natyrës dhe lëmenjve të tjerë.

Drejtori i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Rexhep Elmazi", Nevzat Nevzati, ka falënderuar kryetarin Hyseni për mbështetjen e madhe të ofruar, duke shtuar punimet do të vazhdojnë në planin zhvillimor të shkollës në aspektin e digitalizimit.

Përndryshe, vlera totale e investimeve në këtë shkollë është 216 mijë euro.

500 mijë euro dëmi i shkaktuar nga vërshimet në objektet shkollore në Skenderaj

SKENDERAJ, 7 SHKURT - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka bërë me dije se rreth 500 mijë euro është dëmi i

shkaktuar nga vërshimet e fundit vetëm në objekte shkollore. Nura ka theksuar se si komunë janë në angazhim e

sipër për t'i sanuar dëmtimet nga vërshimet. "Ndërkohë që sot e asaj dite po vazhdojmë me angazhim të madh t'i sanojmë

dëmtimet dhe t'i aftësojmë plotësisht në mënyrë që të rikthehet procesi i rregullt shkollor", ka thënë Nura.



Paga e asamblistit do të jetë nga 556 euro deri në 630 euro

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ndonëse ishin përfaqësuesit e popullit të nivelit komunal, pagat e tyre lënin shumë për të dëshiruar. Pozita e anëtarit të kuvendit komunal, i njohur ndryshe edhe si asamblist, nuk konsiderohej shumë punë e dëshiruar për faktin se paga që merrnin anëtarët e kuvendeve komunale ka qenë shumë e vogël e përgjegjësia e vendimmarrjes ka qenë e madhe.

Shpeshherë partitë politike kanë pasur vështirësi në sjelljen e emrave në kuadër të listave të tyre zgjedhore për shkak se pagat ishin shumë të vogla. Një këshilltar komunal ka marrë pagë bazë 100 euro dhe 125 euro mëditje për pjesëmarrje në seancat e kuvendit komunal. Paga e një anëtari të kuvendit komunal ka qenë hiq më shumë se 225 euro.

Me Ligjin e ri të Pagave është bërë rritje e konsiderueshme e pagave për asamblistët, por të njëjtat përshkallëzohen në varësi të numrit të banorëve që ka komuna përkatëse.

Deri më sot paga e një anëtari të kuvendit komunal ka qenë e njëjtë për të gjithë 225 euro, ndërsa sot për komunën me

numrin më të vogël të banorëve paga bazë është 556.50 euro, ndërsa për komunën me numrin më të madh të banorëve paga bazë është 630.00 euro.

Derisa në të kaluarën anëtarët e kuvendeve komunale kanë marrë mëditje edhe për pjesëmarrjet në komitetet e përhershme, me Ligjin e ri të Pagave kjo mëditje është rregulluar me sa vijon: Anëtarët/ët e Kuvendit Komunal për pjesëmarrje në komitetet e përhershme mund të marrin një shtesë të posaçme prej tridhjetë përlindësh (30 %) të pagës bazë të përcaktuar për anëtarin/in e Kuvendit. Anëtarët/ët e Kuvendit Komunal, që marrin një pagë të rregullt nga buxheti i Kosovës, përfitojnë vetëm shtesën sipas paragrafit 4 të këtij neni. Shtesa sipas paragrafit 4 të këtij neni jepet vetëm një (1) herë brenda muajit dhe paguhet vetëm nëse anëtarët/ët e Kuvendit Komunal marrin pjesë në komitetet e përhershme të Kuvendit Komunal.

Kjo rritje e pagave i prek mbi 1 000 familje në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndërsa për kryesuesit e kuvendeve komunale po ashtu është përdorur formula e numrit të



banorëve në varësi të komunës përkatëse. Psh., për komunën me numrin më të vogël të banorëve paga e kryesuesit do të jetë në lartësinë e gradës/koeficientit 6.3 deri në gradën/koeficientin 7 për

kryesuesin e kryeqytetit.

Kjo rritje e pagave për kryesuesit dhe anëtarët e kuvendeve komunale është premtuese dhe në zgjedhjet e ardhshme lokale që pritet të mbahen në shtator të vitit 2025, listat e partive politike

do të kenë konkurrencë më të madhe brendapërbrenda për përfshirje në lista dhe, gjithashtu, pritet ta rritin cilësinë dhe përfshirjen e sa më shumë profesionistëve nëpër kuvendet komunale.

Në vitin 2022 1 736 raste me sëmundje malinje u paraqitën në QKUK

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHKURT - Bazuar në raportin e punës për vitin 2022 nga Klinika e Onkologjisë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ka pasur gjithsej 1 736 raste të reja me sëmundje malinje. Prej këtyre, 425 raste me kancer të gjirit, 223 raste me kancer të mushkërive, 397 raste me probleme të traktit gastrointestinal, 442 raste me probleme urogjenitale dhe gjinekologjike dhe 249 raste me kancer të kokës-qafës dhe indeve të buta.

Në klinikë, që ka kapacitet prej 12 shtretërve, ka pasur 348 pacientë të shtrirë për trajtim, me gjithsej 2 348 ditë të trajtimit mjekësor. Stafi i klinikës ka trajtuar 47 351 raste

ambulantore dhe ka ofruar 32 272 cikle me citostatikë.

Në Shërbimin e Fizikës Mjekësore të kësaj klinike gjatë vitit 2022 janë kryer 11 741 shërbime në total, nga to janë realizuar dhe aprovuar edhe 2 936 plane për trajtimin e pacientëve.

Ky shërbim në vitin 2022 ka rritur dukshëm numrin dhe kualitetin e shërbimeve, pra ka rritje të vëllimit të punës për 54 për qind në krahasim me vitin 2022 dhe rritje për 149 për qind krahasuar me vitin 2020.

Vitin e kaluar ka filluar aplikimi i tri teknikave të reja për trajtimin e pacientëve (VMAT, IMRT dhe DMLC), po ashtu është funksionalizuar Reparti i Brahiterapisë dhe janë bërë mbi dhjetë ekspertiza për mbrojtje nga rezatimi për klinikat e tjera të QKUK-së.

Konjufca pret në takim shefin e BE-së, bisedojnë për bashkëpunimin e dyanshëm

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim shefin e zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ambasadorin Tomas Szunyog. Në takim u shkëmbyen pikëpamje për zhvillimet aktuale politike, aktivitetin dhe

prioritetet e Kuvendit, si dhe për bashkëpunimin e ndërsjellë dhe agjendën evropiane të Republikës së Kosovës.

Kryetari Konjufca ritheksoi se procesi i dialogut me Serbinë duhet të përmbillet me marrëveshje ligjrisht e

ndërkombëtarisht të obligueshme për normalizimin e plotë të raporteve me njohjen reciproke në qendër. Konjufca dhe ambasadori Szunyog shprehën gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në funksion të mbështetjes së Kuvendit dhe trupave të tij.



Rihapet Aeroporti i Prishtinës pas kërcënimit të rremë me bombë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Kërcënimi me bombë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" të martën në mbrëmje ka

rezultuar të jetë i rremë dhe aeroporti tashmë është i hapur për fluturime ka njoftuar përmes një postimi në "Facebook", zëdhënësja e

aeroportit, Valentina Gara. Pas kërcënimit me bombë, udhëtarët dhe personeli në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ishin evakuuar.

Edhe në fund të dhjetorit të vitit 2022 në Aeroportin e Prishtinës pati një kërcënim me bombë, i cili, gjithashtu, rezultoi i rremë.



ATK-ja: Bizneset online janë të obliguara të lëshojnë kupon fiskal

PRISHTINË, 7 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) i ka njoftuar tatimpaguesit e bizneseve online se duhet të lëshojnë kupon fiskal. "Kuponi fiskal është i obliguar të lëshohet edhe ne rastet kur pagesa bëhet përmes POS-it bankar apo edhe llogarisë bankare. Printimi dhe dhënia e kuponit fiskal është i obliguar në momentin e regjistrimit të furnizimit në pajisje elektronike fiskale", është thënë në njoftimin e ATK-së. Në njoftim e ATK-së është thënë se për të gjitha shërbimet dhe furnizimet e mallrave online, furnizuesi e ka obligim të lëshojë kupon fiskal. "Për të gjitha furnizimet e mallrave dhe/ose shërbimeve përmes internetit (online) furnizuesi obligohet të lëshojë kupon fiskal apo faturë tatimore, varësisht nga

ajo se për kënd bëhet furnizimi. Për furnizimet të cilat bëhen për konsumatorin e fundit (personin fizik joafarist) furnizuesi obligohet të lëshojë kupon fiskal, ndërsa kur furnizimi bëhet për biznesin (personin fizik afarist apo personin juridik) furnizuesi obligohet të lëshojë faturë tatimore", është thënë në këtë njoftim.

Më tutje, ATK-ja ka theksuar se çdo qytetar, për të qenë në gjendje që t'i ushtrojë të drejtat e tij si konsumator, është e rëndësishme të njihet me detyrimet e tij, ku njëra prej tyre është marrja e kuponit fiskal. "Duke marrë kuponin fiskal qytetarët marrin pjesë drejtpërdrejt në 'luftimin' e ekonomisë së hirtë dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të shtetit dhe të shoqërisë", është thënë në njoftimin e ATK-së.



Haradinaj takon aktivistët e fushatës 'Besa Besë': Duke fuqizuar prodhuesit vendorë, forcojmë shtetin tonë



PRISHTINË, 7 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim aktivistët e fushatës "Besa Besë" të kryesuar nga afaristi Burim Piraj. Pas takimit, Haradinaj ka thënë se tarifa 100 për qind i kishte inkurajuar prodhuesit vendorë për rritje të prodhimit dhe të potencialit të tyre. "Gjatë qeverisjes sime rëndësi të veçantë i kemi kushtuar fuqizimit të prodhimeve 'Made in Kosovo'. Taksa 100 për qind e vendosur ndaj produkteve serbe ndikoi pozitivisht në inkurajimin e prodhuesve vendorë për rritje

të prodhimit dhe të potencialit të tyre. Në këtë frymë, kisha kënaqësinë që në selinë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës t'i pres aktivistët e fushatës 'Besa Besë', kryesuar nga Burim Piraj, të cilët me aktivitetin e tyre po arrijnë sukses në vetëdijesimin e qytetarëve për konsumimin e prodhimeve vendorë. Duke fuqizuar prodhuesin vendorë, forcojmë shtetin tonë. Përveç që janë burim i krijimit të vendeve të punës, ata janë kontribuuesit më të mëdhenj për ekonominë e vendit, andaj meritojnë përkrahjen tonë të pazervë", ka theksuar Haradinaj.

ZRrE-ja paralajmëron sërish shtrenjtim të energjisë elektrike

PRISHTINË, 7 SHKURT - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka paralajmëruar shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2023. Kryetari i Bordit të ZRrE-së, Ymer Fejzullahu, para

komisionit parlamentar për ekonomi ka thënë të martën se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për këtë shqyrtim të tarifave. Mirëpo, ai nuk ka dhënë detaje se sa mund të shtrenjtohet energjia elektrike. Duke

paraqitur planin e punës për vitin 2023, Fejzullahu ka thënë se prioritet gjatë këtij viti është edhe rritja e konkurrencës në sektorin e energjisë, por edhe tregu i përbashkët me Shqipërinë. /Ksp/

Numri i Faturës	Vlera e Faturës (EUR)	Vlera e Vlerësimit (EUR)	Vlera e Vlerësimit (EUR)
16590.00	11.14	11.14	11.14
4426.00	0.34	0.34	0.34
16593.00	11.14	11.14	11.14
43970.00	0.34	0.34	0.34
87.00	0.00	0.00	0.00
266.00	0.00	0.00	0.00
87.00	0.00	0.00	0.00
266.00	0.00	0.00	0.00
49	0.0555	2.72	2.72
151	0.0279	4.21	4.21
38	0.0770	2.93	2.93
115	0.0386	4.44	4.44
0	0.1117	0.00	0.00
0	0.0558	0.00	0.00
		2.58	2.58

Çdo gjë vdes. Edhe informacioni



Erik SHERMAN

Çdo gjë vdes: njerëzit, makinat, qytetërimet. Ndoshta mund të gjejmë pak ngushëllim nga fakti se të gjitha gjërat kuptimplota që kemi mësuar gjatë rrugës do të mbijetojnë. Por edhe dija e ka një jetëgjatësi. Dokumentet zbehen. Arti humbet. Biblioteka dhe koleksione të tëra mund të përballen me shkatërrim të shpejtë dhe të papritur. Sigurisht, teknologjikisht ne jemi në një fazë ku mund të krijojmë mënyra për t'i bërë njohurinë të disponueshme dhe të aksesueshme përgjithmonë. Në fund të fundit, dendësia e ruajtjes së të dhënave është tashmë tejet e lartë. Në muzeun gjithnjë në zgjerim të internetit, dikush mund të lëvizë pa problem, nga imazhet e teleskopit hapësinor James Webb, përmes diagrameve që shpjegojnë filozofinë e Pitagorës mbi muzikën e sferave, deri tek një mësim kitare në YouTube. Çfarë mund të duash më shumë? Ka ende, thonë ekspertët. Së pari, ajo që ne mendojmë se është e përhershme nuk është. Sistemet e ruajtjes digjitale mund të bëhen të palexueshme brenda tre deri në pesë vitesh. Bibliotekarët dhe arkivistët garojnë për të kopjuar përmbajtjet në formate më të reja. Por entropia është gjithmonë aty, duke pritur. "Profesionet tona dhe njerëzit tanë shpesh përpiqen të zgjasin jetëgjatësinë normale sa

më shumë që të jetë e mundur përmes një sërë teknikash, por ende po e frenojnë valën," thotë Joseph Janes, profesor i asociuar në Shkollën e Informacionit të Universitetit të Uashingtonit. Për t'i komplikuar gjërat, arkivistët tani po përballen me një përmbajtje të paprecedentë informacioni. Në të kaluarën, materialet ishin të pakta dhe hapësira e magazinimit të kufizuara. "Tani ne kemi problemin e kundërt," thotë Janes. "Gjithçka është duke u regjistruar, gjatë gjithë kohës." Në parim, kjo mund të korrigjohet një gabim historik. Për shekuj me radhë, njerëz të panumërt nuk kishin kulturën, gjininë ose klasën e duhur socio-ekonomike që njohuritë ose veprat e tyre të zbuloheshin, vlerësoheshin apo ruheshin. Por shkalla masive e botës dixhitale tani paraqet një sfidë unike. Sipas një vlerësimi vitin e kaluar nga firma e kërkimit të tregut IDC, sasia e të dhënave që kompanitë, qeveritë dhe individët krijojnë në vitet e ardhshme do të jetë sa dyfishi i totalit të të gjitha të dhënave dixhitale të generuara më parë, që nga fillimi i epokës së informatikës. Shkolla të tëra brenda disa universiteteve po punojnë për të gjetur qasje më të mira për ruajtjen e të dhënave nën ombrellën e tyre. Qendra e të Dhënave dhe Shërbimeve për Shkencat Humane në

Universitetin e Bazelit, për shembull, ka zhvilluar një platformë kompjuterike të quajtur Knora jo vetëm për të arkivuar shumë lloje të të dhënave nga puna e shkencave humane, por për të siguruar që njerëzit në të ardhmen të mund t'i lexojnë dhe përdorin ato. E megjithatë procesi është i ngarkuar. "Ti bën supozime të arsyeshme dhe shpreson për më të mirën, por ka grupe të dhënash që humbasin, sepse askush nuk e dinte se do të ishin të dobishme," thotë Andrea Ogier, ndihmës dekan dhe drejtor i shërbimeve të të dhënave në Bibliotekat Universitare të Virginia Tech. Nuk ka kurrë njerëz apo para të mjaftueshme për të bërë të gjithë punën e nevojshme—dhe formatet po ndryshojnë dhe shumohen gjatë gjithë kohës. "Si i ndajmë më mirë burimet për të ruajtur gjërat? Sepse buxhetet kaq janë," thotë Janes. "Në disa raste, kjo do të thotë që gjërat ruhen, por thjesht qëndrojnë aty, të pakataloguara dhe të papërpunuara, e si pasojë pothuajse të pamundura për t'u gjetur ose aksesuar." Formatet e përdorura për ruajtjen e të dhënave janë në vetvete të përhershme. NASA hoqi rreth 170 kaseta të dhënash mbi pluhurin hënor, të mbledhura gjatë epokës së Apollos. Kur studiuesit vendosën të përdornin kasetat në mesin e viteve 2000, ata nuk mund të gjenin askënd me makinën IBM

729 Mark 5 të epokës 1960, të nevojshme për t'i lexuar ato. Me ndihmë, ekipi përfundimisht gjeti një në formë të përafërt në magazinën e Muzeut Kompjuterik Australian. Vullnetarët ndihmuan në rinovimin e makinës. Softueri gjithashtu ka një jetëgjatësi të caktuar. Ogier kujton se u përpoq të ekzaminonte një skedar të vjetër spreadsheet Quattro Pro, por zbuloi se nuk kishte asnjë softuer të disponueshëm që mund ta lexonte atë. Ka pasur përpjekje për programe të qëndrueshme. Një projekt që mori shumë bujë në vitin 2015 është arkivi i Open Library of Images for Virtualized Execution (Olive), i cili vë në punë softuer të vjetër si Chaste 3.1, një program kërkimor për biologjinë dhe fiziologjinë i vitit 2013 dhe versionin Mac të vitit 1990 të lojës kompjuterike The Oregon Trail në një grup makinash virtuale. Projekti është ende aktiv, thotë Mahadev Satyanarayanan, profesor i shkencave kompjuterike në Universitetin Carnegie Mellon. Por ka pasur sfida në zgjerimin e ofertave të Olive, thotë ai: edhe softueri i papërdorur duhet të licencohet nga kompanitë që e zotërojnë atë dhe shpesh nuk ka mënyrë të lehtë për të futur të dhëna të reja në aplikacionet kërkimore të arkivit. Përpjekjet e tjera për të ndihmuar në rritjen e jetëgjatësisë së

njohurive kanë pasur gjithashtu rezultate të përziera. Arkivi i Internetit, shtëpia e Wayback Machine, ka një koleksion të madh materialesh të dixhitalizuara, duke përfshirë softuer, muzikë dhe video; që nga vera e vitit 2022, ai po lufton një padi për shkeljen e të drejtave të autorit të ngritur nga botues të shumtë. Në anën më shpresëdhënëse, Iniciativa për kodimin e tekstit ka ruajtur standardet ndërkombëtare për kodimin e teksteve të lexueshme nga makina që nga vitet 1990. Një dekadë më parë, Zyra e Politikave të Shkencës dhe Teknologjisë në SHBA përcaktoi që aplikacionet për kërkime duhet të ofrojnë një plan të menaxhimit të të dhënave në mënyrë që të dhënat të mund të përdoren nga studiuesit ose publiku në të ardhmen. "Ne po arrijmë në pikën ku pothuajse çdo projekt kërkimor duhet të vendosë të dhënat e tij diku," thotë Ogier. Por nuk ka kërkesa gjithëpërfshirëse se kush duhet t'i ruajë të dhënat ose për sa kohë duhet të ruhen. Në mënyrë të pashmangshme, idetë, njohuritë dhe krijimet njerëzore do të vazhdojnë të humbasin. "Nuk mund të shpëtojmë gjithçka. Ne nuk mund të ofrojmë akses në gjithçka. Ne nuk mund të marrim gjithçka", thotë Ogier. "Por kjo nuk është arsye për të mos bërë atë që mundemi." / *Technology Review* – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ministri Çeku përgëzon Bad News Eagle për arritjet në garat e lojërave elektronike

PRISHTINË, 7 SHKURT - Ekipi i lojërave elektronike CS:GO, Bad News Eagle, sot është pritur nga ministri i Sportit, Hajrulla Çeku. "Bashkë biseduam për gjendjen e

përgjithshme të ekipit dhe emërimin e trajnerit të ri, agjendën e ndeshjeve për këtë vit dhe synimet e ekipit për të ardhmen", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Duke i vlerësuar për sukseset e jashtëzakonshme në garat e fundit, ministri Çeku u premtoi bashkëpunimin dhe mbështetjen e qeverisë edhe në vazhdimësi.



Hadërgjonaj rrëfen tmerrin që ka përjetuar skuadra e tij nga tërmeti i fuqishëm në Turqi



Stamboll, 7 shkurt - Turqia është goditur nga një tërmet shkatërrues në orët e para të ditës së hënë, duke lënë mbi tetë mijë persona të vdekur, mijëra të lënduar dhe ka ende persona që janë nën gërmadha. Në intervistën për mediumin zviceran, reprezentuesi i Kosovës, Florent Hadërgjonaj, ka thënë se gjithçka është shkatërruar. "Të gjithë janë të traumatizuar. Është një tronditje e madhe", ka thënë Hadërgjonaj. Ish-lojtari i Young Boysit ka kontratë me klubin turk Kasimpasa në ligën e parë që nga viti 2020. Të dielën pasdite klubi i Stambollit luajti kundër Hataysporit, vend që u godit nga një

tërmet i fuqishëm disa orë më vonë. Vetë Hadërgjonaj ka qëndruar në Stamboll për shkak të një lëndimi, por ka qenë dëshmitar i katastrofës. "Ekipi ishte pikërisht aty. Në orën katër të mëngjesit biseda e ekipit ishte plot me mesazhe që u thoshte njerëzve të largoheshin nga hoteli", ka shtuar 28-vjeçari. "Shokët e mi të skuadrës ishin shumë me fat. Gjithçka përreth qytetit ishte shembur", tregoi ai. Tërmeti zgjati rreth dy minuta. Ekipi më pas u nis me makinë për në Adana, rreth dy orë e gjysmë larg vendit ku ndodhi tërmeti më shkatërrues, e prej aty fluturoi për në Stamboll.

Ekipi i mundjes i Kosovës arrin në Stamboll

Prishtinë, 7 shkurt - Ekipi i Federatës së Mundjes së Kosovës ka arritur në Stamboll pas tmerrit që përjetoi nga tërmeti në qytetin Kahramanmarashit të Turqisë. "Pas shumë peripecish, 30 orë rrugë dhe tmerrit të përjetuar nga tërmeti në qytetin Kahramanmarashit të Turqisë, ekipi i Kosovës ka

arritur në Stamboll", thuhet në njoftimin e FMK-së. Tërmeti i fuqishëm që e goditi Turqinë i ka përfshirë edhe disa sportistë kosovarë. Hoteli ku gjendej ekipi i mundësve të rinj të Kosovës u dëmtua nga ky tërmet i tmerrshëm por, fatmirësisht, sportistët nuk kanë pësuar asnjë lëndim dhe u kanë ndihmuar njerëzve nën gërmadha.



Drejtori Rugova: Prishtinën ta bëjmë qytet të sportit

Prishtinë, 7 shkurt - Drejtori i Sportit në komunën e Prishtinës, Granit Rugova, në njëvjetorin e punës të drejtorit të sportit në kryeqytet, ka thënë se janë realizuar shumë projekte gjatë këtij viti. Ai ka thënë se Prishtina duhet të

bëhet qytet i sportit. "Sot një vjet si Drejtor për Sport në Kryeqytet! Para se gjithash, faleminderit kolegëve, klubeve, organizatave, sportistëve dhe qytetarëve për mbështetjen e pakursyer gjatë kësaj periudhe. Bashkë, kemi

realizuar një numër të madh projektesh në vitin e parë, me synimin që në vitin e dytë t'i dyfishojmë ato. Një është qëllimi ynë kryesor në këtë mandat: Që së bashku me ju, Prishtinën ta bëjmë qytet të sportit!", ka shkruar Rugova.



Alonso: Ende mund ta bëj dallimin, do të garoj edhe për 2-3 vjet

MADRID, 7 SHKURT - Piloti spanjoll Fernando Alonso, dy herë kampion bote në Formula 1, këtë sezon do të nisë një kapitull të ri në karrierën e tij. Ai do të garojë me Aston Martin, me shpresën që të rikthehet në majën e këtij sporti. 41-vjeçari, pavarësisht moshës, e sheh veten ende protagonist në këtë sport. "Nuk

do të vazhdoja me këtë sport nëse do të shihja se nuk kam asnjë shans për t'u shpallur sërish kampion bote. Nuk e di nëse kam 1, 10 apo 100 % për ta fituar titullin, por ne besojmë se mund t'ia dalim mbanë. Këtë vit do të punojmë për t'i ngushtuar distancat me rivalët", ka deklaruar Alonso. "Do t'i hedhim

bazat për ta synuar titullin në të ardhmen. Këtu ka një mjedis shumë kompetitiv dhe kjo është e rëndësishme për ta synuar titullin. Unë jam gati të jap pjesën time të kontributit dhe pres të njëjtën gjë nga skuadra. Mendoj se mund të bëj dallimin në çastet vendimtare në gara", ka shtuar Alonso.

Spanjollit ka zhvilluar deri më tani 356 gara në Formula 1, një rekord dhe nuk e sheh afër tërheqjen. "Ky është një sport ku duhet edhe kontroll i situatës, një mendësi fituese. Të ardhmen time do ta vlerësoj vit pas viti, por mendoj se edhe 2-3 vjet do të jem ende në pistë, pasi e di që mund të fitoj", ka thënë Alonso.



Laporta: Këtë vit ëndërroj ta fitojmë ligën, jemi në rrugën e duhur

Barcelonë, 7 shkurt - Barcelona po shkon me hapa të sigurt drejt titullit të kampionit në La Liga. Gjiganti katalunas aktualisht e sheh veten në +8 pikë ndaj rivalit kryesor, Real Madrid. E presidenti Joan Laporta është i vetëdijshëm se "Blaugrana" e kanë thuar në dorë titullin, por që duhet të vazhdojnë me ritëm të njëjtë. "Po shkojmë mirë, në fillim të sezonit do të nënshkruanim për të qenë me 53 pikë në mes të kampionatit, me tetë pikë në avantazh ndaj të dytës. Por, nevojitet ende shumë punë, dedikim dhe angazhim", ka thënë kreu i klubit katalunas në gala mbrëmjen e organizuar nga "Mundo Deportivo". "Xavi po punon mirë, ka arritur në skuadër



në një moment të vështirësisë maksimale dhe i ka bashkuar në mënyrë fantastike shumë lojtarë. Këtë vit ëndërroj ta fitoj ligën, jemi në rrugën e duhur. E dua një

skuadër që është sikur Këshillim im Administrativ apo si të pavarurit që e ndihmojnë klubin që të rritet gjithmonë", ka shtuar Laporta.

Bostoni e Milwaukee duel për kreun në Lindje, Dallasi e Clippersat ngjiten në Perëndim

PORTLAND, 7 SHKURT - Betejë e fortë për kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes mes Bostonit dhe Milwaukee, të dyja fituese në ndeshjet e fundit. Bostoni e mposhti Detroitin (111-99), sfidë ku u dallua Jayson Tatum, autor i 34 pikëve e 11 reboundeve. Ndërsa Milwaukee, falë 27 pikëve të Lopezit e 24 pikëve e 13 reboundeve të Antetokounmpos, mundi me rezultat 127-108 Portlandin. Fitore të rëndësishme për zonën "play-off" korri ekipi i Clippersave, që mundi me rezultat 124-116 Brooklynin jashtë fushës. Paul George me 29 pikë e Leonardo me 24 bënë dallimin për miqtë, ndërsa 47 pikët e Cam Thomasit mbetën për statistikë. Skuadra e Chicagos mundi me rezultat 128-104 San Antonion, ndeshje ku u dalluan Vuçevići me 22 pikë e



Drummond me 21 pikë e 15 rebounde. Një ndeshje të mirë zhvilloi edhe Dallasi, që falë Green e Hardy, me nga 29 pikë secili, mundi me rezultat 124-111 Utah Jazzin (Clarkson 26 pikë). Ekipi kampion i Golden States mposhti me shifrat

141-113 Oklahoman, ndeshje ku shkëlqeu Klay Thompsoni me 42 pikë, autor i 12 gjuajtjeve të sakta për tri pikë. Pa problem fiton Sacramento, që mundi me rezultat 140-120 Houstonin, ndeshje ku u dallua Murray me 30 pikë.

REZULTATET

Detroit - Boston	99-111
Washington - Cleveland	91-114
Brooklyn - Clippers	116-124
Chicago - San Antonio	128-104
Houston - Sacramento	120-140
Utah Jazz - Dallas	111-124
Golden State - Oklahoma	141-114
Portland - Milwaukee	108-127

SHKURT

Ish-lojtari i Chelseat gjendet i gjallë nën rrënoja

Për fat të mirë, ish-futbollisti i Chelseas dhe Newcastle, Christian Atsu, u gjet dhe u nxor i gjallë nga rrënojat. Sulmuesi fillimisht kishte mbetur i bllokuar nën rrënoja siç konfirmoi zëvendëspresidenti i klubit turk Hatayspor, ndërsa një pjesë e madhe e shokëve të tij të ekipit u shpëtuan dhe u transferuan në një vend të sigurt. Lojtari u transportua në spital pasi pësoi dëmtime në këmbën e djathtë dhe u ankua për vështirësi në frymëmarrje. Pjesëtari i këtij klubi vendas që nuk po gjendet, është drejtori sportiv Taner Savut, i cili besohet se është ende nën rrënoja.

Trajneri i Sivassporit: Asistentit tim i vdiqën 15 persona nga familja

Trajneri i klubit turk të Sivassporit, Riza Calımbay, foli për dy tërmete me magnitudë 7.9 dhe 7.5 ballë të shkallës Richter që lanë mijëra të vdekur në Turqi dhe në Siri. Për "BeIn Sport", Calımbay ka thënë se ish-ndihmësi i tij që punon me Hatayspor ka humbur 15 persona nga familja. "Është një ngjarje shumë e trishtueshme. Jemi në Sivas, por jemi gjithashtu mjaft të tronditur. Nuk ka asgjë për të bërë. Sapo u zgjova në mëngjes, telefonova ish-asistentin tim Cengiz, i cili aktualisht punon në Hatayspor dhe më foli për situatën atje. Atij i vdiqën 15 persona nga familja", ka treguar Calımbay.

Më pas trajneri i Sivassporit u ndal edhe te mesazhet dhe aksioni në ndihmë të të prekurve nga tragjedia. "Thirrja e Volkan Demirelit është domethënëse. Ai ishte shumë emocionues, e tha me lot. Është një ditë vërtet e trishtuar dhe e trazuar. Ne do të ndihmojmë si klub, institucionet dhe organizatat duhet të na afrohen në mënyrën e duhur. Ne do të bëjmë më të mirën tonë", ka shtuar trajneri.

Bayerni pritët ta zëvendësojë Neuerin si kapiten me Kimmichin

Manuel Neuer është vendosur sërish në mes të "stuhisë" pas deklaratave të bëra në një intervistë për "Süddeutsche Zeitung", në të cilat ka thënë se ishte i "tronditur" nga shkarkimi i trajnerit të portierëve të Bayernit. Një goditje që nuk i pëlqeu klubit dhe trajnerit Nagelsmann dhe, sipas raportimeve të medieve gjermane, ky episod do t'i kushtojë Neuerit me shiritin e kapitenit, të cilin do ta mbajë edhe Joshua Kimmich edhe kur gardiani të rikthehet në fushë.

Irvingu pritët të kalojë nga Netsi te Dallasi

Ylli i Brooklyn Netsit, Kyrie Irving, ka kaluar te Dallas Mavericks, raporton "The Athletic". Sipas raporteve, Mavericks hoqi dorë nga Spencer Dinwiddie, Dorian Finney-Smith, për ta përfunduar marrëveshjen për Irvingub. Irvingu është te Nets që prej vitit 2019. Më herët ka luajtur edhe për Boston Celticsin dhe Cleveland Cavaliersin. Ai ka pasur epokë të trazuar te Brooklyn. Kishte shumë lëndime, dhjetëra ndeshje të humbura për shkak të refuzimit që të vaksinohet dhe një pezullim në këtë sezon për shkak të promovimit të një filmi me përmbajtje antisemitike.

Djali i Ronaldinhos bëhet pjesë e Barcelonës


Joao Mendes (Joao de Assis Moreira), djali i legjendarit Ronaldinho Gaucho, ka qenë në një periudhë prove te Barcelona që nga fillimi i

janarit. 17-vjeçari, i cili së fundmi ka ndërprerë kontratën me klubin brazilian Cruzeiro, luan si sulmues, ka pasaportë

spanjolle dhe përfaqësohet nga xhaxhai i tij, Roberto de Assis. Në një bisedë në RAC-1, Ronaldinho e bëri fakt të kryer nënshkrimin e djalit të

tij Joao Medes (22-2-2005) për Barcelonën. "Unë nuk jam kurrë jashtë klubit. Barcelona është pjesë e jetës sime. Kudo që shkoj, e marr

Barcelonën me vete. Me ardhjen e djalit tim te Barça, do të jem më i pranishëm këtu", ka rrëfyer Ronaldinho në programin "Tu Diras".



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vera Lleshi nga Doli KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Anton Çeta" doll nga kl I-VIII.
- Yll Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. " Mazllum Këpuska" nga kl. I-X dhe VI-IX në Gjakovë.
- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.
- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).
- Blerta Gjeloşi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni"
- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" (ish Boris Kidric).
- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".
- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.
- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.
- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".
- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".
- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.
- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".
- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.
- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".
- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".
- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.
- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.
- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.
- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjiminazit "Sami Frashëri" Prishtinë.
- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.
- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjiminazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Don Shtjefen Kurti" Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues